

PKR.nr. 344/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtarja, Valbona Musliu-Selimaj, Kryetare e trupit gjykues, me procesmbajtëse Lindita Sylejmani, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale, kundër të akuzuarit N.C., për shkak të veprave penale Ndhima në kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i besimit nga neni 269 par.1 lidhur me nenin 25 të KPK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda, PP.nr.255-9/2012, të datës 30.04.2012, në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me dt.11.05.2018, në praninë e prokurorit të shtetit, Arian Gashi, të akuzuarit N.C., në bazë të nenit 366 të KPPK-së, të njëjtën ditë, mori dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: N.C., nga i ati B. dhe nënës F., e vajzërisë M., i lindur me ..., në fshatin Ll. komuna e P., ku edhe tani, tani me vendbanim të përkohshëm në Gj.– F., i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, punon në Gjermani punë ndërtimtarie, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e paraburgimit dhe në arrest shtëpiak nga data 04.04.2012 deri më dt.30.06.2012.

Konform nenit 363 par.1 nën par 1.3 të KPPK-së,

REFUZOHET AKUZA

SEPSE:

I. Me datën 04.04.2012, rreth orës 01:45 në lokalitë e lojërave “K.” e cila gjendet në P., në rrugën “B.K.”, pronar i të cilës është tani i dëmtuari A.B., i akuzuari B.H. pas një marrëveshje paraprake me të akuzuarin N.C. dhe Mirsad Ukën, M.U. kanë inskenuar marrjen e parave në shumë prej 1070 € dhe një shtëpizë kompjuteri HP, si grabitje nga persona të panjohur dhe pasi që i akuzuari Nysret ka shkuar në lokalitë Kajot i akuzuari B. ia ka dhënë paratë dhe kompjuterin ndërsa rastin e ka paraqitur në polici si i dëmtuar.

- me çka kishte për të kryer veprën penale Ndhima në kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i besimit nga neni 269 par.1 lidhur me nenin 25 të KPK-së.

- sepse ka kaluar afati i parashkrimit absolut dhe ndalesa absolute e ndjekjes penale.

II. Prej kohës së pavërtetuar e deri me datë 04.04.2012 i akuzuari ka mbajtur armë pa autorizim në atë mënyrë që pas kryerjes së veprës penale të përshkruar si në dispozitivin e parë revolen e tipit “Ekol Special 99” me nr. Serik EW-920390, një karikator dhe pesë fishekë të kalibrit 7.65 mm, me paratë dhe kompjuterin e mare në mënyrën e përshkruar si më lartë e dërgon në shtëpinë e axhës së të akuzuarit M.U., ashtu që pas lajmërimit të rastit e njëjta i konfiskohet nga ana e policisë,

- me çka kishte për të kryer veprën penale Mbajtja, në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par 2 të KPK-së

-sepse vepra penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par 2 të KPK-së, për të cilën akuzohej i akuzuari është përfshirë me amnisti, sipas nenit 3 par. 1 nënpar. 1.1 pika 1.1.10 të Ligjit për Amnisti.

- Konfiskohet arma “Ekol Special 99” me nr. Serik EW-920390, një karikator dhe pesë fishekë të kalibrin 7.65 mm

Shpenzimet e Procedurës gjyqësore për të dy veprat penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

Ish PPQ, në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të rënda, me aktakuzën PP.nr.255-9/2012, të datës 30.04.2012, ka akuzuar B.H., për shkak të veprave penale, Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, nga neni 340 par.1 të KPK-së dhe Lajmërimet të rrejshme, nga neni 306 par.1 të KPK-së, N.C. për shkak të veprave penale, Ndhimë në kryerjen e veprës penale, Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.1 lidhur me nenin 23 dhe 25 të KPK-së dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së dhe M.U. për shkak të veprës penale, Ndhimë në kryerjen e veprës penale, Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.1 lidhur me nenin 23 dhe 25 të KPK-së.

Për të akuzuarin N.C. gjykata ka veçuar procedurën penale pasi që ka qenë i paarritshëm për organet e ndjekjes ndërsa e është proceduar ndaras për dy të akuzuarit e tjerë B.H. dhe M.U..

Lidhur me çështjen penale për të akuzuarin N.C. pasi që është siguruar prezenca e tij është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me datë 11.05.2018 ku klane prezantuar prokurori i shtetit dhe i akuzuari.

Pas leximit të aktakuzës, i akuzuari deklaroi se të njëjtën e ka të qartë, nuk ka nevojë për sqarime shtesë dhe deklaroi se ndihet fajtor për veprën penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Përvetësimi në detyrë me të cilat ngarkohet, i vjen keq dhe është i penduar që e ka ndihmuar B.H. dhe se nuk është në dijeni se si është involvuar këtu M.U. kur i njëjti s ka të bëjë asgjë me rastin, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i premtion gjykatës se më asnjëherë nuk do të përsërisë vepra të tilla po të ngjashme.

Konform nenit 248 par. 2 të KPPK-së, prokurori i shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ngase i njëjti pranim është në përputhje me ligjin dhe me provat në të cilat është mbështetur aktakuza, i njëjti me vetëdije të plotë ka pranuar fajësinë andaj i propozon gjykatës që këtë pranim ta aprovojë dhe të njëjtin ta dënojë sipas ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit lidhur mbi dënimin pranimi i fajësisë ti merret si rrethanë lehtësuese.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga i akuzuari, dhe pas marrjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë gjykata konform nenit 248 par. 4 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me aktvendim pranoi pranimin e fajësisë të të akuzuarit për veprën penale si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej, Gjykata nuk administroj prova por vlerësoj se në veprimet e të akuzuarit N.C. nuk përmbushen elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës Përvetësimi në Detyrë nga neni 340 par.1 lidhur me nenin 25 të KPK-së pasi që i akuzuari B.H nuk ka qenë personi zyrtar dhe gjykata sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të përshkrimit faktik të dispozitivit të aktakuzës bënë rikualifikim juridik të veprës penale në veprën penale dhe atë nga vepra penale Përvetësimi në Detyrë në veprën penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Keqpërdorimi i Besimit nga neni 269 par.1 të KPK-së, andaj ndaj të akuzuarit N.C. e refuzoi akuzën për veprën penale të ri kualifikuar Keqpërdorimi i Besimit nga neni 269 par.1 të KPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale dhe ndalesës absolute të ndjekjes penale.

Sipas nenit 106 par.1 nënpar. 1.5 të KPRK-së, (90 par.1 pika 5 të ish KPK-së) ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 (tri) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim, ndërsa komfor nenit 107 par.8 të KPRK-së (91 par.6 të ish KPK-së), ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit. Andaj, nga koha e kryerjes së veprës penale me datë 04.04.2012 e deri me datën e lëshimit të këtij aktgjykimi kanë kaluar më shumë

se gjashtë (6) vite, që do të thotë se ka kaluar më shumë se dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të veprës penale, dhe me datën 04.04.2018 ka arritur parashkrimi absolut dhe ndalesa absolute e ndjekjes penale, prandaj, kjo pike e aktakuzës duhet të refuzohet në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar. 1.3 të KPPRK-së.

Ndërsa sa i përket veprës penale nën dispozitivin e dytë po ashtu gjykata sipas detyrës zyrtare ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e aktakuzës konform nenit 363 par 1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, pasi që vepra penale është përfshirë me Ligjin mbi Amnisti.

Vendimin për konfiskimin e armës së cekur si në dispozitivin e këtij aktvendimi është marrë sipas nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 9 të Ligjit për Amnistinë.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 344/17, datë 11.05.2018

Procesmbajtësja
Lindita Sylejmani

Kryetarja e trupit gjykues
Valbona Musliu-Selimaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.